URDHËR
Nr.222, datë 1.4.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.132, DATË 8.3.2020 "PËR MBYLLJEN E AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ANULLIMIN E GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma "a", të ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1 dhe 2 të urdhrit nr.132, datë 8.3.2020 "Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anullimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura", togfjalëshi "deri në datën 3 prill 2020", zëvendësohet me togfjalëshin "deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu